



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 4318 Prot.

Tiranë, më 28/07/2022

URDHËR

NR. 387, DATË 28/07/2022

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 5862, DATË 16.09.2015
"PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT "

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, nenit 4 dhe 67 pika 2 të Ligjit nr. 110/2018, "Për Noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e pikës 2, germa a,b,c, të Urdhrit nr. 5862, datë 16.09.2015, si vijon:

Ngritja e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a) Znj. [REDACTED], Specialist në Sektorin e Veprimtarisë Noteriale;
- b) Znj. [REDACTED], Specialist në Sektorin e Veprimtarisë Noteriale;
- c) Z. [REDACTED], Kryetar i Degës Vendore të noterisë Korçë;
- d) Z. [REDACTED], Anëtar i Dhomës Kombëtare të Noterisë Tiranë.

2. Ndryshimin e pikës 3, të Urdhrit nr. 5862, datë 16.09.2015, si vijon:

Arkiva t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noteres, së Degës Vendore të Noterisë Korçë, znj. [REDACTED] pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noteria plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.

3. Ndryshimin e pikës 7, të Urdhrit nr. 5862, datë 16.09.2015, si vijon:

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, të marri masat e nevojshme për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës, si dhe ish-noterit [REDACTED].

4. Shtimin e pikës 8 në Urdhrin 5862, datë 16.09.2015, si vijon:

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të kryejë veprimet e nevojshme për të mbështetur kryerjen dhe marrjen në dorëzim të arkivit.

5. Shtimin e pikës në Urdhri date 16.09.2015, si vijon:

Ngarkohet Sektori i Arkiv- Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës:

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

ULSI MANJA

